

VENDIM
Nr. 717, datë 29.10.2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR.668, DATË 15.10.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR
KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E
SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR
PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT
TË DYTË ME KOHË TË PLOTË,
"MASTER PROFESIONAL" DHE
"MASTER I SHKENCAVE" APO "MASTER
I ARTEVE TË BUKURA", PËR VITIN
AKADEMIK 2014 - 2015"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 34, 36 e 75, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye ose për shkak të detyrës", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.668, datë 15.10.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Paragrafi i parë, i pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Kuotat e përgjithshme të pranimi në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2014-2015, në programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, "Master Profesional", janë 7 223 (shtatë mijë e dyqind e njëzet e tre) kuota gjithsej, të ndara, si më poshtë vijon:".

2. Shkronja "a", e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Kuotat për pranimet e reja 7073".

3. Shkronja "a", e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Kuotat e pranimi për kandidatët brenda

territorit të vendit 6653".

4. Pas shtojcës 1 shtohet shtojca 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Kuotat e pranimi në programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave" apo "Master i Arteve të Bukura", të parashikuara, përkatësisht, në shkronjat "a", të pikave 2 dhe 4, të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit në institucionet publike të arsimit të lartë, pasqyrohen përkatësisht në tabelat nr.1, nr.1/1 dhe nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi."

6. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. Studentët transferojnë studimet nga një program i ngjashëm studimi i mëparshëm "Master Profesional" në një program tjetër studimi "Master Profesional" apo nga një program studimi "Master i Shkencave" ose "Master i Arteve të Bukura" në një program tjetër studimi "Master i Shkencave" apo "Master i Arteve të Bukura", në institucionet publike të arsimit të lartë, duke iu nënshtruar tarifës për kredit të programit të studimit, në të cilin ata kanë kërkuar të transferojnë studimet, të përcaktuar në tabelat nr.1, nr. 1/1 dhe nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi."

7. Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"14.Studentët që aplikojnë në institucionet publike të arsimit të lartë për të vazhduar studimet në një program studimi të ciklit të dytë, me kohë të plotë, "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave"/"Master i Arteve të Bukura", për vitin akademik 2014-2015, përzgjidhen në bazë të kriterëve të vendosura nga vetë këto institucione."

8. Pika 17 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"17. Tarifat e shkollimit për kredit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave" apo "Master i Arteve të Bukura", në vitin akademik 2014-2015, pasqyrohen përkatësisht në tabelat nr.1, nr. 1/1 dhe nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi."

9. Pika 20 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"20. Studentët, që transferojnë studimet në një program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave" apo "Master i Arteve të Bukura", në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës për kredit për program të dytë studimi, sipas tabelave nr.1, nr. 1/1 dhe nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi, për lëndët e mbetura në programin e studimit përkatës, në të cilin ata kanë kërkuar të transferojnë studimet."

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet

publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA 1/1

KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË “MASTER PROFESIONAL”,
PËR VITIN AKADEMIK 2014-2015

Emërtimi i universitetit	ID_programit	Emërtimi i programit	Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit	Tarifa për kredit për program të parë studimi	Tarifa për kredit për program të dytë studimi
Universiteti i Bujqësor i Tiranës	152	Menaxhim i ndërmarrjeve, me profil "Menaxhim i ndërmarrjeve të agrobiznesit"	100	1,200	1,440
Universiteti i Bujqësor i Tiranës	153	Ekonomi dhe politikë agrare, me profil "Ekonomi dhe politikë agrare"	100	1,200	1,440
Universiteti i Bujqësor i Tiranës	154	Ekonomi dhe biznes, me profil "Financë kontabilitet"	100	1,200	1,440
Universiteti i Bujqësor i Tiranës	155	Menaxhim mjedisi	60	1,200	1,440
Universiteti i Bujqësor i Tiranës	156	Zhvillim rural dhe mjedisor i qëndrueshëm	60	1,200	1,440
Universiteti i Bujqësor i Tiranës	157	Mbrojtja kimike dhe fitofarmacia	35	1,200	1,440
Universiteti i Bujqësor i Tiranës	158	Teknologjia e kultivimit të bimëve	35	1,200	1,440
Universiteti i Bujqësor i Tiranës	159	Teknologji e avancuar në hortikulturë	35	1,200	1,440
Universiteti i Bujqësor i Tiranës	160	Biznes blegtoral	25	1,200	1,440
Universiteti i Bujqësor i Tiranës	161	Cilësia dhe siguria ushqimore	100	1,200	1,440
Universiteti Politeknik i Tiranës	162	Teknologji informacioni	60	1,000	1,430
Universiteti Politeknik i Tiranës	163	Inxhinieri tekstili dhe mode	20	1,000	1,430
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	164	Mësuesi AM në biologji, me profil minor në kimi	30	1,000	1,200
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	165	Mësuesi, për arsimin e mesëm, në Matematikë	30	1,000	1,200
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	166	Ekonomiks në sipërmarrje	40	1,000	1,200
		TOTALI	830		